



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.869/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Afijete Sada - Gllgjani Kryesuse, Burim Ademi dhe Zyhdi Haziri anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Fushë Kosovës Safete Çitaku, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Fushë Kosovë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet pjesërisht si i bazuar apeli Anr.869/2021 i datës 04.11.2021, i paraqitur nga kandidata për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Fushë Kosovës Safete Çitaku, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Fushë Kosovë, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal të Fushë Kosovës, nga radhët e subjektit politik nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë dega në Fushë Kosovë, në vendvotimet VV 0913E/01D, 0907E/01R, dhe 0902E/03R në Komunën e Fushë Kosovës.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë e Vendvotimeve si në pikën **-II-** të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

IV Refuzohet i pabazuar apeli Anr.869/2021 i datës 04.11.2021, i kanidates për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Fushë Kosovës Safete Çitaku, nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Fushë Kosovë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, në pjesën me të cilën ka kërkuar rinumërimin e vendvotimeve VV 0906E/01D.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidatja për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Fushë Kosovës Safete Çitaku, nga Subjekti Politik PDK me të cilën pretendon se në vendvotimin VV 0913E/01D komisionerët e këtyre vendvotimeve kanë manipuluar me vota pasi që i mungojnë votat e sigurta të familjarëve në këtë vendvotim, në vendvotimin VV 0907E/01R komisionerët kanë bërë ndërhyrje në formularë ku shihet qartë se fillimisht ka pasur 12 vota ndërsa më pas është bërë 002 dhe pastaj janë korrigjuar edhe kandidatët e tjerë për përshtatje të votave të subjektit me atë të kandidatëve. Po ashtu në vendvotimin VV 0906E/01D shihet qartë se numri i votave i kandidatëve është më i lartë se sa numri i votave të subjektit politik nga ku shihen edhe këtu ndërhyrje në formularë si dhe në vendvotimin VV 0902E/03R në fshatin Bardh i Madh janë favorizuar dy kandidatë që vijnë nga po i njëjti fshat si në vendvotim dhe shihen ndërhyrje tek numri 24 ashtu që nga 9 vota është bërë përmisimi dhe janë vendosur 4 vota.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton se kandidatja për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Fushë Kosovës Safete Çitaku, nga Subjekti Politik PDK, me seli në Prishtinë, dega në Fushë Kosovë brenda afatit ligjor, ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i votave në Vendvotimet VV 0913E/01D, 0907E/01R, 0906E/01D dhe 0902E/03R në Komunën e Fushë Kosovës.

Paneli pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës për të vërtetuar gjendjen faktike të rastit konkret, ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga KQZ-ja me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit, ashtu që nga provat e bashkangjitura krahas apelit përkatësisht Formularit të Rezultateve të Kandidatëve vërehet se ka ndërhyrje tek numri total i votave tek numri i kandidatës Safete Çitaku, nga Subjekti Politik PDK, me numrin 24 ku vërehet se janë bërë përmirsimet nw numra.

Andaj ky panel, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparenca, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura. Si në pikën II të dispozitivit.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, të vendosur si në pikën -IV-, të dispozitivit paneli, vlerëson se kandidatja për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Fushë Kosovës Safete Çitaku, nga Subjekti Politik PDK, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Fushw Kosovws kërkon rinumërimin e votave për vendvotimin VV 0906E/01D është i pa bazuar për faktin se për të njëjin vendvotim, KQZ-ja veç e ka marrë vendim për rinumërim para se rezultati përfundimtar të publikohet andaj të njëjtat janë të rinumëruara, për këto arsye paneli vlerëson se një rinumërim tjetër për të njëjtin vendvotim të rinumëruar nga KQZ-ja në QNR, është i pa arsyeshëm.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 869/2021 më datën 06.11.2021.



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.